



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje paisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (Shkolla "Edith Durham" dhe Shkolla "Shejnaze Juka"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39160000-1 - Mobilje shkollore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 7,401,784** (shtatë milion e katërqind e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës e përkatësisht **2,960,714** (dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar

kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

**2.2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi Të Ardhurat”, të Ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41, pika 5/ c), nenin 43, të

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit ne nje vlere prej **1,480,357 (një milion e katërqind e tetëdhjetëmijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë ne konsiderate vlerën e fondit limit te furnizimit te kerkuar objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete realizuar kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal te lejuar dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **4 (kater)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në vendosjen e numrit minimal të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si grafiku i lëvrimit të mallrave, transporti, montimi, zhvendosja dhe sistemimi i tyre në ambientet e dy shkollave, riparimi dhe çdo proces tjetër përgjatë periudhës së garancisë. AK nuk ka përcaktuar detyra të veçanta për punonjësit duke ia lënë organizimin e tyre kontraktorit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, shoqëruar me listepagesat është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 4 persona, është në përputhje me volumnin e kontratës, natyrën dhe terrenin ku do të furnizohen mallrat.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik prodhues/tregtar duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mobiljesh. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (e vlefshme).
- Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit
- *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumenti:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë venddorezimit të tyre në destinacionin përkatës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Eshtë kërkuar një kamion të përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete të nevojshme për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata është komplekse me shumë artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 9001- 2015** ose e perditesuar **Sistemet e menaxhimit të cilësisë** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë

*Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

- 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **ISO 45001-2018, ose e perditesuar** Për sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne punë (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK eshte kërkuar zotërimi i certifikatave:

ISO 9001- 2015 - Sistemet e menaxhimit te cilësisë

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar me qëllim furnizimin me pajisje cilësorë nisur nga fakti që bëhet fjalë për institucione arsimore dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet dhe perben nje garanci nga ofertuesi per cilesine e mallrave dhe suportin teknik mbeshtetes qe do te perdoren gjate ekzekutimit te kontrates . Eshte nje kerkese gjeresisht e njohur dhe e perdorur ne prokurimet publike ku cilesia e mallrave te fabrikuara dhe montimit te tyre eshte element preferencial i zbatimit te kontrates

ISO 45001-2018 - Certificate per menaxhimin e sistemit te sigurise dhe shendetit perfaqeson nje kerkese bazike te domosdoshme , e normatizuar edhe nga Kodi i punes i RSH dhe vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në shkolla

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. 11 Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

**2.3.8** Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

- Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori, për pajisjet e ofertuara.  
Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 40, pika 8, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Kjo kërkesë është përcaktuar me qëllim që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar.

- Katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, për pajisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga



paisjet e ofruara me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse paisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës për paisjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën. Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë...”*

**2.3.9** Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë çertifikatat e produktit si më poshtë:

- Tavolinë nxënësi cikli i ulët SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Tavolinë nxënësi cikli i lartë: SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 , e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Karrige nxënësi cikli i ulët : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Karrige nxënësi cikli i lartë : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Karrige mësuesi: SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 e njëvlefshme ose e përditësuar
- Tavoline pune : EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Dollap për klasa (Raft) : SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Karrige rrotulluese (zyre): SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ,e njëvlefshme ose e përditësuar

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet të jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet të disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

**Tavolinë nxënësi cikli i ulët/cikli i lartë SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015** e njëvlefshme ose e përditësuar., standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt I femijes. EN 1729-2:2012+A1:2015, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat per nxenes per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore si dhe pershkruan metodat e testimi qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e keture mobiljeve.

**Karrige nxenesi cikli i ulët/cikli i lartë SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015**, standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt I femijes. SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat e nxenesve per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen e femijeve,si dhe pershkruan metodat e testimi qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e ketyre mobiljeve.

**Karrige mesuesi SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018**, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimive te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione. SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

**Tavolinë mësuesi:** EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, standart qe specifikon permasat qe duhet te plotesoje produkti. EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në tavolinat e punës.

**Dollap për klasa** SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, Standart që nenkupton që produkti dollap I është nënshtruar testeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e forcës dhe peshave të ndryshme që mund të jenë të pranishme gjatë funksionimit normal të dollapit. Gjithashtu testeve u nënshtrohen edhe pjesët përberëse të dollapit. Një certifikate e tillë nenkupton që dollapi në teresinë e tij plotëson kërkesat e fortësisë, rezistencës dhe qëndrueshmërisë.

**Karrige rrotulluese** SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me dimensionet që duhet të ketë një karrige për përdorim të zakonshëm në mënyrë që të sigurohet një qëndrim i përshtatshëm për të punuar dhe gjithashtu përshkruan edhe metodat e testeve të kryera për përcaktimin e tyre. Një certifikate e tillë nenkupton që produkti i prodhuar respekton këto dimensione. SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart që specifikon kërkesat që duhet të plotësojnë këto karrige për sa i përket sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë për një përdorim rreth 8 orë në ditë dhe për një person që peshon deri në 110 kg. Një certifikate e tillë nenkupton që produkti është i sigurtë për një përdorim të tillë. Këto standarte shoqërohen bashkë. Një certifikate e tillë nenkupton që mobilja e prodhuar i plotëson këto standarte.

**Argumentimi ligjor :** neni 44 pikat 1,2,3,4 të VKM të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar

**Argumentimi i AK:** Certifikatat e pikës 2.3.9 , kanë lidhje të ngushtë me objektin e mallrave që prokurohen dhe përbejnë një standart akreditues thelbësor lidhur me cilësinë/sigurinë e materialeve në fushën e mobilimit të dedikuar për ambjente shkollash lidhur me suprinat e tavolinave, karrigave etj, elemente si qëndrueshmëria e tyre vecanerisht karshi të nxehitjes dhe lageshtisë , lidhur me fortësinë e materialeve , me pjesët e levizshme të dollapeve/vitrinave apo parametrave të tjera gjatë fazës së realizimit të tyre.

**2.3.10** Operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, të jenë:

Tavolinë nxënësi cikli i ulët:

Tavolinë nxënësi cikli i lartë:

Karrige nxënësi cikli i ulët:

Karrige nxënësi cikli i lartë:

Karrige mësuesi:

Tavolinë mësuesi:

Dollap për klasa:

Karrige rrotulluese:

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, përben kusht skualifikues.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 gërma a), gërma c) e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Vendosja e kriterit të sipërcituara ka për qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë të interesuar me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses. Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. AK gjykon se dorëzimi i mostrave është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga ana e AK janë kërkuar mostra në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim mostrash AK krijon siguri të plotë dhe vërteton plotësisht përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Shkoder, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Qellimi i këtij prokurimi është blerja e dy mjeteve Fadromë dhe Kamion Vetshkarkues me Vinc ne plotesim te nevojave te Drejtorise se Sherbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve te Infrastruktures per ti perdorur ne funksion dhe zbatim te detyrave te sektorit te emergjencave civile ne raste emergjencash si dhe sektorit te infrastruktures.*

*Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja gjithmonë e në rritje për mjete të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme.. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*